

**Tony B. Watlington Sr., Ed.D.**  
Kryeinspektor

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Javën e kaluar, Drejtoria Arsimore e Filadelfias mori një lajm emocionues. Të Mërkurën Raportin “[Education Recovery Scorecard /Karta e Rezultateve të Rikuperimit të Arsimit](#) – i publikuar nga Qendra për Kërkimin e Politikave Arsimore të Universitetit të Harvardit dhe Projekti i Mundësisë Arsimore në Universitetin Stanford. Ky raport studjoi ndikimin e pandemisë në mësimin e studentëve dhe shkallën e rikuperimit në drejtoritë arsimore në 30 shtete, që përfaqësojnë rreth 60% të popullsisë kombëtare që shkon në shkollë.

Sipas këtij studimi, **Drejtoria Arsimore e Filadelfias (SDP) po tejkalon drejtoritë e tjera të mëdha urbane në mbarë vendin, dhe drejtori të ngjashme në Pensilvani, në rikuperimin nga pandemia.**Në matematikë, studentët e Filadelfias rikuperuan gati gjysmën e nivelit të të mesuarit gjatë vitit shkollor 2022-2023. Në lexim, studentët e Filadelfias rikuperuan rritje më të vogla gjatë së njëjtës periudhë. Ja se si SDP krahason:

- Krahasuar me drejtoritë e tjera të mëdha urbane në mbarë vendin:
  - Në Matematikë, krahasuar me drejtoritë më të mëdha dhe më të varfra nga zonat urbane pjesëmarrëse që marrin provimin “[National Assessment of Educational Progress \(NAEP\)](#)” /[Vlerësimi Kombëtar i Progresit Arsimor \(NAEP\)](#), SDP është më e shpejti për t’iu afruar niveleve të arritjeve të Matematikës para pandemisë. Drejtoria e Unifikuar Arsimore e Los Angeles ishte më e afërta e radhës.
  - Në Lexim, SDP tejkaloi nivelet e leximit para pandemisë dhe tregoi më shumë rritje se shumica e drejtorive të tjera të mëdha urbane pjesëmarrëse nga 2019 në 2023, dhe vetëm Shkollat Publike të Chicago treguan më shumë rritje.
- Krahasuar me drejtoritë të ngjashme në Pensilvani:
  - Në Matematikë,SDP është më afër niveleve të arritjeve para pandemisë në krahasim me shtetin dhe drejtoritë e ngjashme në PA (Shkollat Publike të Pittsburgh, Drejtoria Arsimore e Zonës Bethlehem, Shkollat Publike Erie, Drejtoria Arsimore Scranton,Drejtoria Arsimore e Zonës Wilkes-Barre) të cilat janë ende prapa.
  - Në Lexim, SDP është mbi nivelet para pandemisë në krahasim me shtetin dhe drejtoritë e ngjashme (Shkollat Publike të Pittsburgh, Drejtoria Arsimore e Zonës Bethlehem, Shkollat Publike Erie, Drejtoria Arsimore Scranton,Drejtoria Arsimore e Zonës Wilkes-Barre), të cilat janë ende prapa.

Përveç kësaj, javën e kaluar Isha i nderuar të mbaja fjalimin e parë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias për Arsimin Publik. Ngjarja ofroi një mundësi të vlefshme për Drejtorinë Arsimore dhe Bordin e Arsimit që të qëndrojnë të bashkuar me Qytetin e Filadelfias dhe të ndajnë publikisht përparimin që kemi bërë, strategjitë tona për përsheptimin e mëtejshëm të arritjeve akademike dhe një thirrje për veprim për të vazhduar investimin në Fëmijët e Filadelfias. Nëse e keni humbur ngjarjen, mund ta shikoni regjistrimin [këtu](#).

Të dhënat nga Karta e Vlerësimit të Rimëkëmbjes së Arsimit dëshmojnë se së bashku ne jemi “[Accelerating Philly!](#)” Megjithatë, ndërsa ne po festojmë këtë progres, si komunitet kemi ende shumë punë për të bërë. Ne do të vazhdojmë të harmonizojmë burimet tona për të përmirësuar më tej rezultatet e nxënësve dhe për t’u bërë drejtoria arsimore urbane me përmirësim më të shpejtë në vend. Kërkoj mbështetjen dhe partneritetin tuaj të vazhdueshëm ndërsa ne vazhdojmë të punojmë për të përgatitur çdo student për të imagjinuar dhe realizuar çdo të ardhme që dëshiron.

Në partneritet,

*Tony*

Tony B. Watlington Sr., Ed.D.  
Kryeinspektor  
Drejtoria Arsimore e Filadelfias